



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2896/ 12 prot.

Datë 06.01.2026

V E N D I M
Nr. 11/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.01.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INERTI” Sh.p.k në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF- 60262-09-03-2025, me objekt “Ndërtimi i një kompleksi poligoni qitjeje dhe palester për forcat operacionale dhe ato speciale në Sistemin e Burgjeve”, me fond limit 296,309,312.26 (*dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e treqind e nëntë mijë e treqind e dymbëdhjetë pikë njëzet e gjashtë*) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin e propozimit teknik të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INERTI” Sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” Sh.p.k në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF- 60262-09-03-2025, me objekt “Ndërtimi i një kompleksi poligoni qitjeje dhe palester për forcat operacionale dhe ato speciale në Sistemin e Burgjeve”, me fond limit 296,309,312.26 (*dyqind e nëntëdhjetë e*

gjashtë milion e treqind e nëntë mijë e treqind e dymbëdhjetë pikë njëzet e gjashtë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INERTI” Sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k & “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin e propozimit teknik të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INERTI” Sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin e propozimit teknik të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” Sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin e propozimit teknik të ofertës të paraqitur nga BOE “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k & “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Ankimues:

BOE “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k me NUIS K71401004Ë, me adresë: Rruga Adem Jashari, Ndertesa 4, Hyrja 10, Njesia Bashkiake Nr.5 & “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k me NUIS L41513008A Tirane, Njesia Bashkiake Nr.4 Kodi Zip 1007 , Rruga Aleksander Moisiu , Ndertesa 117, Zona kadastrale Nr.8130.

BOE “BE - IS” sh.p.k me NUIS K71412003A, me adresë: Godina Nr.2, Heci Veleshice, Kalis, Zall Kalis, Kukes & “ERGI” sh.p.k me NUIS K02727229P & “HTM” sh.p.k., me NUIS K97006004D

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “INERTI” Shpk, me NUIS J66926804L, me adresë: Elbasan GRAMSH L. SPORTI.

Operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” Shpk, me NUIS K61625001I, me adresë: Kryqëzimi i Rugës "Liman Kaba" me "Prokop Mima", Rezidenca "Olimpik" , Shkalla nr. 2, Kati 4, Tiranë.

BOE “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k me NUIS K71401004Ë, me adresë: Rruga Adem Jashari, Nderresa 4, Hyrja 10, Njesia Bashkiake Nr.5 & “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k me NUIS L41513008A Tirane, Njesia Bashkiake Nr.4 Kodi Zip 1007 , Rruga Aleksander Moisiu , Nderresa 117, Zona kadastrale Nr.8130.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

- I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.
- I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.
- I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- I.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.09.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF- 60262-09-03-2025, me objekt “Ndërtimi i një kompleksi poligoni qitjeje dhe palester për forcat operationale dhe ato speciale në Sistemin e Burgjeve”, me fond limit 296,309,312.26 (*dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e treqind e nëntë mijë e treqind e dymbëdhjetë pikë njëzet e gjashtë*) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 19.09.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 01.10.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE: “BE - IS” sh.p.k&“ERGI” sh.p.k&“HTM” sh.p.k 242,290,650 223.95 pikë
2. BOE: “DESARET COMPANY” sh.p.k&”AURORA KONSTRUKSION” sh.p.k 254,342,546.85 I skualifikuar
3. OE: “INERTI” sh.p.k 194,460,287.28 259.50 pikë
4. BOE: “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k& “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k 210,461,923.43 246.45 pikë
5. OE: “ASI-2A CO” sh.p.k 280,000,000 I skualifikuar

6. OE: "DION-AL" sh.p.k 202,744,391.63 I skualifikuar
7. OE: "ED KONSTRUKSION" sh.p.k 218,618,500 245.10 pikë
8. OE: "K A C D E D J A" sh.p.k 18,921,898.63 I skualifikuar
9. BOE: "L.T.E CONSTRUCTION" sh.p.k& "ZEQILLARI" sh.p.k 251,451,582.05 212.70 pikë
10. BOE: "ALKO IMPEX CONSTRUCTION" sh.p.k& "ALKO-IMPEX General Construcion" sh.p.k& "MF INVEST GROUP" sh.p.k 207,307,051.50 I skualifikuar
11. OE: "PEPA GROUP GROUP" sh.p.k 235,925,981.7 I skualifikuar
12. OE: "PE - VLA – KU" sh.p.k 237,370,251.88 I skualifikuar
13. BOE: "G.P.G. COMPANY" sh.p.k & "SENKA" sh.p.k 270,297,846 I skualifikuar
14. BOE: "Z D R A V A" sh.p.k & "BAJRAMI N." Sh.p.k 231,985,076.53 I skualifikuar

II.4. Në datën 14.10.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE "Formular Njoftim - Fituesi", për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 61, datë 20.10.2025.

II.5. Në datën 17.10.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2896/2025 protokoli, me datë 17.10.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5954 e BOE "KEVIN KONSTRUKSION" sh.p.k & "APIS CONSTRUCTION" sh.p.k, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës dhe vlerësimit me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik "INERTI" Shpk, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5.1. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 2896/1 prot., datë 20.10.2025, ku do të publikohen kriteret e vecanta të kualifikimit, kriterin e vlerësimit dhe objektin e pretendimeve që BOE "KEVIN KONSTRUKSION" sh.p.k & "APIS CONSTRUCTION" sh.p.k, i cili pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik "INERTI" Shpk, në procedurën e mësipërme të prokurimit, të parashtruara në ankesën me nr. 2896 prot., datë 17.10.2025.

II.5.2. Operatori ekonomik "APIS CONSTRUCTION" sh.p.k, ka dorëzuar pranë KPP_së, një deklaratë drejtuar autoriteti kontraktor dhe per dijeni Komisionit te Prokurimit Publik, të protokolluar me tonën me nr. 2896/2 prot., datë 20.10.2025, ku deklaron se tërhiqet nga procedura e prokurimit.

II.5.3. Autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara , ka dërguar me sistemin elektronik, vendimammarjen e KSHA, "Vendimi i KSHA 119/2025", me nr. 2718/7 prot., datë 24.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2896/3 prot., datë 24.10.2025, është dërguar

nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së bashkimit i operatorëve ekonomikë ankimues, ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

II.5.4. Nëpërmjet shkresës përcjellëse me nr. 2718/8 prot., datë 24.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2896/4 prot., datë 27.10.2025, me objekt “*Mbi shqyrtimin e ankesës*” dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor (“Vendimi i KSHA 119/2025”, me nr. 2718/7 prot., datë 24.10.2025), informacioni mbi trajtimin e ankesës së bashkimit i operatorëve ekonomikë ankimues, ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

II.5.4. Me datë 29.10.2025, operatori ekonomik “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k, ka dorëzuar me shërbim postar pranë KPP_së, një deklaratë të protokolluar me tonën me nr. 2896/5 prot., datë 29.10.2025, ku deklaron se rikonfirmon angazhimin si pjesë e BOE dhe shpreh vullnetin për të vijuar pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit.

II.5.5. Me datë 29.10.2025, operatori ekonomik “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k, ka dorëzuar me shërbim postar pranë KPP_së, një kërkesë të protokolluar me tonën me nr. 2896/6 prot., datë 29.10.2025, ku kërkon shqyrtimin e plotë të ankesës A/2025/5954.

II.5.6. Me shkresën me nr. 18524 prot., datë 12.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 2896/7 prot., datë 14.11.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka paraqitur një kërkesë për trajtimin e përshpejtuar të ankesës.

II.5.7. Me shkresën me nr. 2896/8 prot., datë 26.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, për të dërguar dokumentacionin e plotë fizik të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “INERTI” SHPK, të njehsuar me origjinalin dhe të numerizuara.

II.5.8. Nëpërmjet shkresës përcjellëse me nr. 2718/14 prot., datë 04.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 2896/9 prot., datë 09.12.2025, me objekt “*Kthim përgjigje shkresës me nr. 2896/8 prot., datë 26.11.2025*” dërguar me shërbim postar, informacioni i kërkuar.

II.6. Në datën 20.10.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2913/2025 protokoli, me datë 20.10.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5960 e BOE “BE - IS” sh.p.k & “ERGI” sh.p.k & “HTM” sh.p.k, për procedurën e prokurimit, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës dhe vlerësimit me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “INERTI” Shpk, operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” Shpk dhe BOE “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k & “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k, në procedurën e mësipërme të prokurimit, të parashtruara në ankesën me nr. 2913 prot., datë 20.10.2025.

II.6.2. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin,

adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 2913/1 prot., datë 21.10.2025, ku do të publikohen kriteret e vecanta të kualifikimit, kriterin e vlerësimit dhe objektin e pretendimeve që BOE “BE - IS” sh.p.k & “ERGI” sh.p.k & “HTM” sh.p.k., pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “INERTI” Shpk, operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” Shpk dhe BOE “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k & “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k, në procedurën e mësipërme të prokurimit, të parashtruara në ankesën me nr. 2913 prot., datë 20.10.2025.

II.6.3. BOE “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k & “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k, ka dorëzuar Formularin e paraqitjes së argumentave si subjekt i interesuar, protokolluar me tonën me nr. 2913/2 prot., datë 23.10.2025.

II.6.4. OE “ED KONSTRUKSION” sh.p.k, ka dorëzuar Formularin e paraqitjes së argumentave si subjekt i interesuar, protokolluar me tonën me nr. 2913/3 prot., datë 27.10.2025.

II.6.5. Autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara , ka dërguar me sistemin elektronik, vendimammarjen e KSHA, “Vendimi i KSHA 121/2025”, me nr. 2718/11 prot., datë 28.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2913/4 prot., datë 28.10.2025, është dërguar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së bashkimit i operatorëve ekonomikë ankimues, ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

II.6.6. Nëpërmjet shkresës përcjellëse me nr. 2718/12 prot., datë 28.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2913/5 prot., datë 29.10.2025, me objekt “*Mbi shqyrtimin e ankesës*” dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor (“Vendimi i KSHA 121/2025”, me nr. 2718/711 prot., datë 28.10.2025), informacioni mbi trajtimin e ankesës së bashkimit i operatorëve ekonomikë ankimues, ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

II.6.7. Me shkresën me nr. 20037 prot., datë 09.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 2913/6 prot., datë 10.12.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka paraqitur një kërkesë për trajtimin e përshpejtuar të ankesës.

II.6.8. Me shkresën me nr. 20037 prot., datë 09.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 2913/7 prot., datë 12.12.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka paraqitur një kërkesë për trajtimin e përshpejtuar të ankesës.

II.6.8. Me shkresën me nr. 21036/1 prot., datë 23.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 2913/8 prot., datë 24.12.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka paraqitur një kërkesë për anulim të procedurës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “KEVIN CONSTRUKSION” sh.p.k & “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “INERTI” Shpk me arsyen se: “.....Operatori ekonomik iInerti sh.p.k. ka paraqitur dokumentet e subjektit mbfështetës (statusin aktiv, vërtetimet tatimore dhe të sigurimeve shoqërore) me data pas përfundimit të afatit të dorëzimit të ofertave, duke ndryshuar përmbajtjen thelbësore të ofertës në kundërshtim me nenin 26 të VKM nr. 285/2020 dhe nenin 91 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të cilët ndalojnë cdo dorëzim apo modifikim dokumentacioni pas afatit. Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, operatori ka deklaruar se i plotëson të gjitha kriteret ligjore të pranimit, megjithëse dokumentet reale që vërtetojnë këtë janë lëshuar vetëm pas afatit të ofertës, cka përbën deklarim të rreme sipas nenit 76, pika 1, shkronja “d” dhe nenit 77, pika 1, shkronja “a” të Ligjit 162/2020. Ky fakt krijon dyshime të arsyeshme se në momentin e ofertimit operatori ose subjekti mbështetës mund të ketë qenë debitor aktiv ndaj tatimeve apo sigurimeve dhe vetëm pasi është klasifikuar i pari ka rregulluar detyrimet, duke përfutur në kundërshtim me parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme të parashikuara në nenin 3 të Ligjit për Prokurimin Publik. Për rrjedhojë, oferta e këtij operatori duhet të konsiderohet e pavlefshme për shkak të ndryshimit të ofertës pas afatit ligjor dhe deklarimit të rreme.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standartet të tenderit, kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar: ;

Shtojca 7.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pagtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 8.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.1.2. Nga shqyrtimi i informacioni dhe dokumentacionit të dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor, të operatorit ekonomik “INERTI” SHPK, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin edhe të subjektit mbështetës “ViaNex” Shpk:

- Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për subjektin mbështetës ViaNex Shpk datë 01.10.2025;
- Vërtetim (Për Statusin Aktiv/Pasiv/Të tjera) me nr. xxxxx datë 01.10.2025 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër;
- Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore me nr. xxx datë 02.10.2025 për shtetasin Znj. V. G.;
- Vërtetim me nr. xxx prot., datë 01.10.2025 lëshuar nga Sektori i Gjendjes Gjyqësore për subjektin “ViaNex” SHpk;
- Vërtetim me nr. xxx prot., datë 18.07.2025 lëshuar nga Sektori i Gjendjes Gjyqësore për subjektin “ViaNex” SHpk;
- Certifikat regjistrimi lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për subjektin Vianex Shpk me datë 02.10.2025;
- Vërtetim lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër me nr. xxxx datë 05.09.2025 E-Sig 02/a për subjektin ViaNex Shpk;
- Vërtetim (Për pagim detyrimesh) me nr. xxxxx datë 03.09.2025 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër për subjektin ViaNex Shpk;
- Vërtetim për shlyerje e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore me datë 25.06.2025 për subjektin “Rroku Guest” SHpk;
- Ekstrakt Historik i Regjistrimit të Pronarit përfirues për subjektin “Rroku Guest” Shpk me datë 01.10.2025;
- Deklarata “Listpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi”, Muaji Maj 2025, për subjektin Rroku Guest Shpk lëshuar me datë 18.07.2025;
- Deklarata “Listpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi”, Muaji Qershor 2025, për subjektin Rroku Guest Shpk lëshuar me datë 18.08.2025;
- Deklarata “Listpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi”, Muaji Korrik 2025, për subjektin Rroku Guest Shpk lëshuar me datë 01.10.2025;
- Vërtetim Debie me nr. xxxxx datë 02.09.2025, ku rezulton se Rroku Guest Shpk nuk rezulton debitor;
- Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit të subjektit ViaNex Shpk datë 19.09.2025 (ish-Rroku Guest” Shpk)
- Deklaratë Angazhimi/mbështetje teknike lëshuar nga subjekti ViaNex Shpk;
- Kontratate punës me dokumentacion shoqërues për stafin teknik që do të mbështese subjektin ofertues “Inerti” Shpk;

III.1.3. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.4. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.*

III.1.5. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.

7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

III.1.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: 1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 20të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.7. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;*
- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.*
- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.*
- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.*

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit.

Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, nëpërmjet kriterëve për kualifikim, synohet sigurimi i ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e tenderit janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e

kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Nisur nga pretendimet më sipër të ankimuesit, për kualifikimin e OE “Inerti” Shpk, i cili është mbështetur në kapacitetin teknik, konkretisht të stafit teknik tek subjekti mbështetës “ViaNex” SHpk, Komisioni nga shqyrtimi i informacionit të dërguar nga autoritetit kontraktor si edhe të dokumentacionit fizik të dorëzuar në protokollin e autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik “Inerti” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur, ku për përmbushjen kriterëve të përgjithshme të kualifikimit ka kryer deklaratimet si në pikën III.1.2 të këtij vendimi. Duke qenë se operatori ekonomik “Inerti” SHPK, sipas vendimit të KVO-së është operatori ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në pikë 2, të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumente të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së nëpërmjet shkresës përcjellëse me nr. 2718/14 prot., datë 04.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 2896/9 prot., datë 09.12.2025, me objekt “*Kthim përgjigje shkresës me nr. 2896/8 prot., datë 26.11.2025*” dërguar me shërbim postar, informacioni i kërkuar, bashkë me dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike në brendësi të të cilit gjendet dokumentacioni për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit, “.....Operatori ekonomik “Inerti” sh.p.k. ka paraqitur dokumentet e subjektit mbështetës (statusin aktiv, vërtetimet tatimore dhe të sigurimeve shoqërore) me data pas përfundimit të afatit të dorëzimit të ofertave, duke ndryshuar përmbajtjen thelbësore të ofertës.....” dhe duke i ballafaquar me kriteret e përgjithshme të kualifikimit, me dokumentacionin fizik të paraqitur nga operatori ekonomik “Inerti” Shpk, në autoritet kontraktor për përmbushjen e kriterit të cituar më sipër, KPP gjykon, se referuar përmbajtjes së formularit përmbledhës të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik “Inerti” SHPK konkretisht në pjesën Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, ka deklaruar në mënyrë të qartë përmbushje e të gjitha rubrikave (QKB, statusi aktiv, vërtetimet gjyqësore, tatimore, Ekstrakt të regjistrimit të pronarëve përfitues të thjeshtë dhe historik). Gjithashtu operatori ekonomik “Inerti” SHPK ka dorëzuar në autoritetin kontraktor, në bazë të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dokumentacionin e deklaruar më sipër, të subjektit mbështetës “ViaNex” Shpk, i cili shërben si provë për vërtetimin e deklaratimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, me qëllim përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit se dokumentacioni i subjektit mbështetës “ViaNex” Shpk, i dorëzuar fizikisht pranë AK nga operatori ekonomik “Inerti” SHPK nuk janë të vlefshme ditën e dorëzimit të ofertave (datë 19.09.2025), rezulton e provuar nga informacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor në KPP me shkresën nr. 2718/14 prot., datë 04.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 2896/9 prot., datë 09.12.2025, se bazuar në këto pretendime operatori

ekonomik “Inerti” SHPK ka paraqitur fizikisht në autoritet kontraktor dokumentet si më poshtë:

- Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për subjektin mbështetës ViaNex Shpk datë 01.10.2025;
 - Vërtetim (Për Statusin Aktiv/Pasiv/Të tjera) me nr. xxxxx datë 01.10.2025 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër;
 - Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore me nr. xxx datë 02.10.2025 për shtetasin Znj. V. G.;
 - Vërtetim me nr. xxxx prot., datë 01.10.2025 lëshuar nga Sektori i Gjendjes Gjyqësore për subjektin “ViaNex” SHpk;
 - Vërtetim me nr. xxxx prot., datë 18.07.2025 lëshuar nga Sektori i Gjendjes Gjyqësore për subjektin “ViaNex” SHpk;
 - Certifikat regjistrimi lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për subjektin Vianex Shpk me datë 02.10.2025;
 - Vërtetim lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër me nr. xxxxx datë 05.09.2025 E-Sig 02/a për subjektin ViaNex Shpk;
 - Vërtetim (Për pagim detyrimesh) me nr. xxxxxx datë 03.09.2025 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër për subjektin ViaNex Shpk;
 - Vërtetim për shlyerje e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore me datë 25.06.2025 për subjektin “Rroku Guest” SHpk;
 - Ekstrakt Historik i Regjistrimit të Pronarit përfirues për subjektin “Rroku Guest” Shpk me datë 01.10.2025;
 - Deklarata “Listpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi”, Muaji Maj 2025, për subjektin Rroku Guest Shpk lëshuar me datë 18.07.2025;
 - Deklarata “Listpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi”, Muaji Qershor 2025, për subjektin Rroku Guest Shpk lëshuar me datë 18.08.2025;
 - Deklarata “Listpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi”, Muaji Korrik 2025, për subjektin Rroku Guest Shpk lëshuar me datë 01.10.2025;
 - Vërtetim Debie me nr. xxxx datë 02.09.2025, ku rezulton se Rroku Guest Shpk nuk rezulton debitor;
 - Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit të subjektit ViaNex Shpk datë 19.09.2025 (ish-Rroku Guest” Shpk)
 - Deklaratë Angazhimi/mbështetje teknike lëshuar nga subjekti ViaNex Shpk;
 - Kontratate punës me dokumentacion shoqërues për stafin teknik që do të mbështese subjektin ofertues “Inerti” Shpk;
- Nisur nga pretendimet e ankimuesit i cili kërkon të verifikohen dokumentacioni fizik i dorëzuar në përmbushje të deklarimeve të bëra në Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit të subjektit mbështetës “ViaNex” Shpk, pasi dyshon se ato nuk janë të vlefshme ditën e hapjes së ofertave, referuar dokumentacionit më sipër të paraqitur nga operatori ekonomik “Inerti” SHPK në autoritet kontraktor me qëllim përmbushjen e kriterit të përgjithshëm të kualifikimit, rezulton e provuar se disa nga dokumentacionet e sipërcituara, të deklaruara, nuk janë të vlefshëm në ditën e hapjes së ofertave, e cila referuar SPE rezulton me

datë 19.09.2025 dhe rrjedhimisht pretendimi i ankimuesit qëndron, pasi ato figurojnë të lëshuara pas kësaj date. KPP nga shqyrtimi i dokumentacionit më sipër të paraqitur në autoritet kontraktor nga operatori ekonomik “Inerti” SHPK vëren se, për dokumentacionin si: *QKB, statusi aktiv, vërtetimet gjyqësore, tatimore, Ekstrakt të regjistrit të pronarëve përfitues të thjeshtë dhe historik*, në përmbushje të deklarimeve të bëra në Formularin Përmbledhës së Vetdeklarimit të Subjektit mbështetës “ViaNex” Shpk të datës 19.09.2025, nuk janë të vlefshme në datën e hapjes së ofetave në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi figurojnë të datës pas hapjes së ofertave, duke mospërmbushur në këtë mënyrë edhe kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe si rrjedhim pretendimi i BOE ankimues qëndron.

Sa më lart pretendimet e BOE ankimues qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k & “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k. mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Inerti” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, referuar gjykimit mësipër në pikën III.1., gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Inerti” SHPK do të vijoje të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “BE - IS” Shpk & “ERGI” Shpk & “HTM” Shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Ed Konstruksion” Shpk me arsyen se: “.....Mosplotesimi i saktë dhe korrekt i Formularit të Vetdeklarimit në Shtojca 8: Formulari nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat sipas kërkesave standarde. Në mënyrë të vecantë, mungojnë të dhëna të sakta mbi: - Konfliktin e interesit, - Administratorin e shoqërisë, - Pronarin përfitues dhe rubrikat e makinerive e stafit të punonjësve, specialistëve e stafi teknik ingjinerik Praktika e vendimmarrjes së KPP-së e konsideron mosplotësimin e saktë të formularit të vetdeklarimit si shkak për skualifikim.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në pikën 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1.a, të shtojcës 8, “Formular i Kriereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, **sipas Shtojcës 8.**

III.3.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Formular Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës nr.8 të DT

III.3.3. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: 1. *Çdo operator ekonomik që*

është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;
- c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;
- ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

- a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;
- b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në

një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashikuar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratë të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pagtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe

raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim..

III.3.4. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore

minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.5 Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.3.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij . Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur

III.3.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.3.8. Ninsur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, shtojcën 8, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në përmbushje të kriterit 1.a të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Në këtë formular vetëdeklarimi, sikurse paraqitet edhe në pikën III.3.2 të këtij vendimi, vërehet se operatori ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK, dhënë informacion dhe dokumentacionin apo institucionin ku mund të kryhet verifikimi i këtij informacioni për të gjitha rubrikat që lidhen me plotësimin e kërkesave të përgjithshme të kualifikimit. Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referues për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP. Çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet si e pa vlefshme. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 8, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke s dhënë të dhënat e nevojshme për të gjitha rubrikat të cituara më sipër në këtë vendim sic ky formular parashikon. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më lart, KPP gjykon se operatori ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK ka plotësuar të gjitha rubrikat e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, pasi ka dhënë informacionin që ky formular kërkon, duke plotësuar kështu pikën 2.a të Kriterëve të veçanta të kualifikimit, për dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

Për sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “BE - IS” Shpk & “ERGI” Shpk & “HTM” Shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Ed Konstruksion” Shpk, me arsyen se: *“.....Mungesa e dokumentacionit të plotë dhe të saktë për punët e ngjashme (pika 2.3.1 e KVK-së): Pavarësisht pretendimeve tona për ligjshmërinë e këtij kriteri dhe praktikës së konsoliduar të KPP për formulime të tilla,*

operatori ED KONSTRUKSION sh.p.k. nuk e përmbush këtë kriter për sa i përket dokumentacionit të kërkuar e që duhet të bashkelidhet kontrates për të deshmuar plotësimin e këtij kriteri. Në disa prej kontratave mungon certifikate e marrjes në dorezim punimeve e disa kontratave ju mungon fatura tatimore, keto mungesa referuar praktikës së vendimarrjes së KPP është shkak ligjor skualifikimi.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **148,154,656.13** (njëqind e dyzetë e tetë milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë trembëdhjetë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **592,618,624.52** (pesëqind e nëntëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e katër pikë pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të siperpermendura e bën oferten të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit;
 - Certifikatën e marrjes në dorezim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i

përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim : Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore perkatese të deklaruara në organet tatimore.
- Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shënim : Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.

Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

III.4.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

Nr	Pershkrimi I dokumentit
1	Formular Vleresimi per OE "Ed Konstruksion" per objektin "Rikonstruksioni I shkolles 9 vjecare"
	Kontrate me nr. xxxx prot datë xxxx
	Situacion perfundimtar
	Certifikat e perkoshme e marrjen ne dorezim te punimeve
	Akt kolaudimi
	Fatura tatimore
2	Formular Vleresimi per OE "Ed Konstruksion" per objektin "Qendra e ekselencës pr zhvillim rajonal dhe vendor"
	Kontrate me nr. xxx prot., datë xxx

	Njoftim per marrjen ne dorezim te perkoheshem të objektit me nr. 624/4 prot., datë 20.06.2023
	Akt kolaudimi
	Fatura tatimore
	Sitacion perfundimtar
	certifikat e marrjen ne dorëzim te perkoshem te objektit
3	Formular Vleresimi per OE "Ed Konstruksion" per objektin "Rikonstruksion per Qendrat e Kontrollit Teknik Tirana 1 dhe Tirana 2"
	Kontrate me nr. xxx prot., datë xxx
	Certifikat e perkoshme e marrjes ne dorezim te punimeve
	Proces verbal kolaudimi
	Sitacion perfundimar
	Fatura tatimore
4	Formular Vleresimi per OE "Ed Konstruksion" per objektin "Ndertim I Godines TIP në RSU 2 (Nr,3)"
	Kontratae me nr. xxxx prot., datë xxxx
	Akt kolaudimi
	Procesverbal marrje ne dorezim (perkoheshem)
	Sitacion perfundimtar
	Fatura Tatimore
5	Formular Vleresimi per OE "Ed Konstruksion" per objektin "Rikonceptim dhe unifikim I veshjeve strukture dhe shesheve funksionale ne disa Drejtori Rajonale, ndarë në 2 Lote", Loti 1 "Rikonstruksion dhe permiresim I ambjenteve te Drejtoris Rajoanle Tirane"
	Kontrate me nr. xxxx prot., datë xxx
	Akt kolaudimi
	Certifikat e perkoshme e marrjes ne dorezim te punimeve
	Situacion perfundimtar
	Fatura Tatimore
6	Formular Vleresimi per OE "Ed Konstruksion" per objektin "Rikonstrusion I plote dhe mobilim I shkolles 9 vjecare "Lalm"
	Kontrata
	Certifikata e marrjes se perkoshme ne dorezim te punimeve

	Situacion perfundimtar
	Fatura tatimore
7	Formular Vleresimi per OE "Ed Konstruksion" per objektin "Rikonceptim i kopshtit zoologjik"
	Situacion perfundimtar
	Akt kolaudimi
	Procesverbal marrje ne dorezim (perkoheshem) te objektit
	Fatura tatimore
	Formuara Vleresimi per OE "Ed Konstruksion" per objektin "Rikonceptim I kopshitit zoologjik"
	Kontrate shprese me nr. xxx prot., date xxxx
	Akt kolaudimi
	Situacion perfundimtar
	Procesverbal marrje ne dorezim (perkoheshem) te objektit
8	Formular Vleresimi per OE "Ed Konstruksion" per objektin "Ndertim grup depo per pajisjet e kerkimitshpetimt dhe akomodimi I kompanise se kerkimitshpetimit ne repartin ushtarak nr. 4030 (Ferraj, Tirane) "
	Kontrate me nr. xxxx prot., date xxxx
	Situacion perfundimtar
	Akt kolaudimi
	Akt marrje ne dorezim te objektit
	Fatura tatimore
9	Formular Vleresimi per OE "Ed Konstruksion" per objektin "Ndertim I Godines TIP në RSU 1 (Nr.15)"
	Kontrate nr. xxx prot., date xxx
	Amendim kontrate me nr. xxx prot., date xxx
	Procesverbal kolaudimi
	Certifikat e perkoshme e marrjes ne dorezim te punimeve
	Situacion perfundimtar
	Fatura tatimore
10	Formular Vleresimi per OE "Ed Konstruksion" per objektin "Rikonstruksion I godines se autoritetit per informimin mbi dokumentet e ish sigurimit te shtetit"

	Certifikat e marrjes ne dorezim te perkoshem te punimeve
	akt kolaudimi
	Kontrate me nr. xxx prot., date xxx
	Fatura tatimore
	Situacion perfundimtar
	Cerifikat e marrjes ne dorezim perfundimtare e punimeve
11	Formular Vleresimi per OE "Ed Konstruksion" per objektin Godine banimi dhe sherbime 7 dhe 9 kat, me 2 kat parkimi nentoke"-sipermarrje private
	Leje ndertimi
	Situacion perfundimtar
	Akt kolaudimi
	Certifikat perdorimi
	Fatura tatimore
	Kontrate sipermarrje baze -pronare trualli-firme ndertimi me nr. Rep xxxx, nr. Kol xx, date xxxx

III.4.3. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.4.4. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

III.4.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.6. Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të provojë, se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që

prokurohet. Për përmbushjen e kriterit kualifikues, të përcaktuar në pikën 2.3.1, pjesë të dokumenteve standarde të tenderit, për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.4.2.

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike, ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer), shoqëruar me Kontratë Sipërmarrje, Situacionin përfundimtar, Aktin e kolaudimit dhe Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim ose me sektorin privat me paraqitjen e vërtetimeve lëshuar nga subjekti privat të shoqëruar Kontrate Sipërmarrje, Situacionin përfundimtar, Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe Akt kolaudimi objekti, *ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme.

III.4.7. KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha dokumentacionit shoqërues të kontratave të sipërcituara, në pikën III.4.2, duke nisur nga pretendimi i BOE ankimuese se në disa kontrata mungon fatura tatimore dhe në disa kontrata mungon certifikata e marrjes në dorëzim/Çertifikata e Përkohshme të marrjes në dorëzim, të dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK, konstatohet se të gjitha kontrata të realizura me entet publike janë të shoqëruara me Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer), shoqëruar me Kontratë Sipërmarrje, Situacionin përfundimtar, Aktin e kolaudimit dhe Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim si edhe një kontratë e realizuar me sipërmarrje private është me dokumentacion shoqërues Kontrate Sipërmarrje, Situacionin përfundimtar, Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe Akt përdorimi të objektit. Rrjedhimisht pretendimet e BOE ankimues në lidhje me mungesën fizike të dokumentit si fatura tatimore dhe në disa kontrata mungon certifikata e marrjes në dorëzim/Çertifikata e Përkohshme të marrjes në dorëzim për kontratat e realizuara me ente publike apo edhe ato me sipërmarrje private nuk qëndrojnë. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë, se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, por edhe në përputhje me volumin e

përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, referuar pretendimeve të ngritura nga BOE ankimues, për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Ed kontruksion” SHPK, Komisioni konstaton, se pretendimet e BOE ankimues nuk qëndrojnë.

Rrjedhimisht pretendimet e BOE ankimues nuk qëndrojnë.

III.5. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “BE - IS” Shpk & “ERGI” Shpk & “HTM” Shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Ed Konstruksion” Shpk, me arsyen se: “.....Operatori nuk disponon për realizimin e punimeve të kësaj kontrate numrin e fuqisë punëtore të kërkuar në pikën 2.3.4 të KVK-se. Në këtë pikë janë kërkuar gjithësej disponimi i së paku 100 punonjës kurse operatori nuk e disponon këtë numër në tre muajt e fundit. Në disponojmë të dhëna se deri në muajin gusht ky operator ka patur të punësuar jo më shumë se 75 punonjës. Pra, do të mjaftonte vetëm mosplotësimi i këtij numri total të punonjësve të kërkuar që ky operator të skualifikohet sepse mesataren e tre muajve të fundit ka patur të punësuar më pak se numri i kërkuar në pikën 2.3.4 të KVK-se.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.4. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

“2.3.4.Një punësim minimalisht prej **100 (njëqind) punonjës**, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për **3 muajt** e fundit të deklaruar”.

III.5.2. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
Informacione për nënkontraktorin			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar
Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik			
Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

--	--	--	--

Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se: Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të
--

ndryshuar. Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër¹. Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me: çmimet; metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose, paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë. Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike. Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës

¹ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:
- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. - Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. - Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

“Për permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. _____, me profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë _____ sonë, në rolin e _____, 2. _____, me profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë _____ sonë, në rolin e _____, 3. _____, me profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë _____ sonë, në rolin e _____, Makineri e mjete Po [] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete

C: DEKLARATË

“PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME

PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do te me vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

Kontratë furnizimi	
---------------------------	--

Materiali/pro dukti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera	
1.				
2				
3				
4				

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jënë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut të punimeve. Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar: Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, etj ., i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetëdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër

- *Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.*
- *Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.*
- *Ofertuesi i kualifikuar i pari, si dhe kandidatet e kualifikuar në fazën e parë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojnë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuar.*
- *Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.5.3. Në përmbushje të kriterit më sipër cituar, OE “Ed Konstruksion” Shpk ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK, me datë 19.09.2025;

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekte kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjës të nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve mesatarisht 79 (shtatëdhjetë e nëntë) punonjës për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:

- Deklaratë anagazhimi nga subjekti mbështetës “O.B. Konstruksion” shpk, i cili do të mbështeti OE “Ed Konstruksion” shpk në lidhje me kriterin 2.3.4. për numrin e punonjësve.
- Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “O.B. Konstruksion” shpk;

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve mesatarisht 37 (<i>tridhjetë e shtatë</i>) punonjës për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. 21 (<i>njezete e një punonjes</i>) për plotësimin e kriterit 2.3.4 të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:

Living Houses & Industrial Buildings
 KRUJE –ALBANIA
 Mobile: +355 682005490 / +355 682050213
 E-mail: obkonstruksion@yahoo.com

III.5.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.5.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.5.6. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;
- c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;
- ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

- a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;
- b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një

marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.5.7. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.5.8. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.

7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

III.5.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për

operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

III.5.10. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;

- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.

- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilat e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit.

Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi."

III.5.11. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kriteret e vendosura me anë të dokumentacionit të dorëzuar në përputhje dhe me përcaktimet ligjore. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga

neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që puna/shërbimi/malli i ofruar është në përputhje me kërkesat e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i tyre duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.5.12. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.5.13. Nisur nga pretendimet e BOE ankimues se operatori ekonomik “Ed Konstruksion” shpk, nuk përmbush kriterin 2.3.4 të DT në lidhje me numrin e punonjësve të kërkuar, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku në Pjesa I, pika B, është dhënë informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK. Konkretisht, do të mbështetet mbi kapacitetet e operatorit ekonomik “OB Konstruksion” SHPK përse i përket përmbushjes së numrit të punonjësve në pikën 2.3.4 të DT. Nga shqyrtimi, i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Ed konstruksion” shpk, konstatohet se ky i fundit, për operatorin ekonomik “OB Konstruksion” SHPK, si subjekt mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet, ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “OB Konstruksion” SHPK, si dhe deklaratë e angazhimit të këtij të fundit. Marrëveshje Angazhimi e datës 19.09.2025 midis palës mbështetëse “OB Konstruksion” SHPK dhe palës së mbështetur “Ed Konstruksion” SHPK, në të cilën citohet se pala mbështetëse do të mbështesë me kapacitete njerëzore shoqërinë “Ed Konstruksion” SHPK dhe kjo e fundit pranon këtë mbështetje”.

Komisioni gjykon se, referuar nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operatorë ekonomik konkretisht parashikohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor

në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një anqazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Ndërsa në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se 1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme; - t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së; - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor. Në Neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se, për pikën 1 të nenit 76 të Ligjit “Për Prokurimin Publik”, nga ana e operatorit ekonomik duhet të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në rregullat e prokurimit publik. Referuar dokumenteve të tenderit, në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, në pjesën e fundit përcaktohet, se, “në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”.

Në procedurën objekt-shqyrtimi, operatori ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK, ka deklaruar si një nga subjektet në kapacitetet e të cilit do të mbështetet, operatorin ekonomik “OB Konstruksion SHPK, ku përveç Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të tij, ka paraqitur edhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “OB Konstruksion” SHPK, si dhe një deklaratë se për këtë subjekt nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikim ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së dhe se do të vë në dispozicion fuqi punonjësish 21 (njëzet e një punonjës) për plotësimin e kriterit 2.3.4, ku janë kërkuar minimalisht prej 100 (njëqind) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Gjithashtu, ka paraqitur dhe një Marrëveshje Angazhimi të datës 19.09.2025 të palës

mbështetëse “OB Konstruktion” SHPK , në të cilën citohet se pala mbështetëse do të mbështesë me kapacitete njerëzore shoqërinë “Ed Konstruktion” SHPK. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE në përmbushje të kriterit 2.3.4, dhe nisur nga pretendimet e BOE ankimese, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “Ed konstruktion” Shpk ka dorëzuar Formularit e tij Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku në Pjesën III: Kriteret e Përzgjedhje/Kualifikimit, B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ku ka deklaruar se disponon mesatarisht 79 (shtatëdhjetë e nëntë) punonjës. Në këtë kontekst, KPP, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, Komisioni gjykon se, në pikën 1 të nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: *“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. Ndërsa në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se 1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme; - t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së; - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor*

Pra, në rastin konkret, BOE ankimes pretendon se subjekti “Ed Konstruktion” SHPK, nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.4 të DST –së, ndërkohë që referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit operatori ekonomik “Ed Konstruktion” SHPK ka deklaruar se në lidhje me Kapacitetin 2.3.4 ka deklaruar se disponon mesatarisht 79 (shtatëdhjetë e nëntë) punonjës dhe për njënumër punonjësish, do të mbështetet në kapacitetet e operatorit ekonomik “OB Konstruktion” SHPK, ku përveç Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të tij, ka paraqitur edhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “OB Konstruktion” SHPK, i cili ka deklaruar se do të vërë në dispozicion fuqi punonjësish 21 (njëzet e një punonjës) për plotësimin e kriterit 2.3.4 të DT. Gjithashtu ka paraqitur dhe një Marrëveshje Angazhimi të datës 19.09.2025 të palës mbështetëse “OB Konstruktion” SHPK në të cilën citohet se pala mbështetëse do të mbështesë me kapacitete njerëzore shoqërinë “ED Konstruktion” SHPK. Ndërkohë që, referuar pikës 1 të nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ligjvënësi ka parashikuar se Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet

ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, ndërsa në pikën 1 dhe 2 të nenit 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka parashikuar se Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. Por kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet që - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme; - t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së; - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike SPE nga operatori ekonomik Ed Konstruksion” SHPK për përmbushjen e kriterit të kualifikimit 2.3.4 të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit është plotësisht i vërtetueshme se përmbushet nga ana e këtij operatori ekonomik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të nenit 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe për sa kohë janë respektuar të hapat procedurale, të parashikuara në ligj dhe vkm për sa i përket mënyrës dhe sasisë së përmbushjes së kriterëve nëpërmjet mbështetjes në kapacitetet e operatorëve të tjerë ekonomik. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Ed konstruksion” Shpk, i plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm, për këtë fazë.

Për sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “BE - IS” Shpk & “ERGI” Shpk & “HTM” Shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Ed Konstruksion” Shpk, me arsyen se: “.....Operatori ED KONSTRUKSION shpk nuk ka arritur të deshmojë plotësimin e pikës 2.3.5 pasi lidhur me këto kriter, në njohuritë tona mbi këto operator na rezulton se ky operator nuk ka në licence të shoqërisë së drejtues teknik profesionet arkitekt dhe Inxhinier Elektronik /IT / Telekomunikacion.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

“2.3.5.Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- **1 (një) Arkitekt**
- **1 (një) Inxhinier Ndertimi**
- **1 (një) Inxhinier Ndertimi profili Strukturist**
- **1 (një) Inxhinier Elektrik**
- **1 (një) Inxhinier Mjedisi**
- **1 (një) Inxhinier Mekanik**
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder**
- **1 (një) Inxhinier Gjeolog**
- **1 (një) Inxhinier Elektronik/IT/Telekomunikacion**

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK”.

III.6.2. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në SPE, në përpmbushje të pikës së sipërcituar në DT, operatori ekonomik “Ed konstruksion” SHPK në pikën B “Deklaratë” në seksionin “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” dhe në pikën D “Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera”, ka bërë deklaram, konkretisht kjo pjesë është ngarkuar në sistem si më poshtë vijon:

-Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit të OE “Ed Konstruksion” shpk;

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjës të nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve mesatarisht 79 (shtatëdhjetë e nëntë) punonjës për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. Z. “ ”, me profesion Arkitekt, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit teknik/Arkitekt,

	10. Z. _____ me profesion Ing.Telekomunikacion, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit technik/Ing.Telekomunikacion, i çertifikuar per “sistemet CCTV”,
--	---

-Licenca NZ.4981/21 e subjektit “Ed Konstruksion” Shpk;

III.6.3. Në nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet;

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.”.

6. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe të gjeneruar automatikisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike.

8. Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të operatorit, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve. Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dosjes virtuale të operatorit duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike, për aq sa është e mundur, në dosjen virtuale të operatorit.

9. Për operatorët ekonomikë vendas, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme.

10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose kopje të noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike, të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimit. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen online në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5 u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin e-Certis për të marrë informacion për llojet dhe format e provave të përmendura në këtë nen dhe për autoritetet kompetente, që i lëshojnë ato në shtetet anëtare të Bashkimit Europian.”

III.6.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
 - b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
 - c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
 - ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
 - d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
 - dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
 - e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
 - g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
 - gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
 - h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
 - i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
 - j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
 - k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.
3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

III.6.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.6.6. Refruar arsyes së skualifikimit të OE ankimes, pretendimeve të tij dhe materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ KPP konstaton se ky i fundit ka paraqitur në sistem Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”,

“d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontrator të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Pra, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatori ekonomik duhet të deklarojë për punonjësit e mesiperm, referuar profilit të punës dhe numrit. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit të tij, konstatohet, se në lidhje me kërkesën punonjësit sipas profileve të kërkuara në pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanata të kualifikimit, operatori ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK ka deklaruar në *pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate”,* se disponon këto punonjës specialistë sipas profile respektive, konkretisht punonjësit: -Z.J.Ç., me profesion Arkitekt, në rolin e Drejtuesit Teknik/Arkitekt, i disponueshëm edhe në Licencën e shoqërisë, Z. M. N. me profesion Inxhinier Telekomunikacioni, në rolin e Drejtuesit Teknik, i disponueshëm edhe në Licencën e shoqërisë. Si dhe, në seksionin D “Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera”, ka deklaruar stafin teknik sipas profesioneve të cilët janë edhe në Licencën e shoqërisë, ku për secilin prej tyre ka deklaruar emrin dhe profilin e punës. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga OE “Ed Konstruksion” shpk në procedurën e prokurimit, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm, për këtë fazë.

Pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “BE - IS” Shpk & “ERGI” Shpk & “HTM” Shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Ed Konstruksion” Shpk, me arsyen se: *“....Operatori Ed Konstruksion shpk nuk ka vetdeklaruar ne shtojcen 8, disponimin e stafit teknik te kerkuar ne piken 2.3.7 te KVKse lidhur me Dëshmi te Sigurimit Teknik e leshuar nga ISHTI ose nga nje trup Certifikuese e akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise..... Nga ky dokumentacion do te vereje se per disa nga specialitet si: Murator, Instalues dhe riparues te sistemeve ngrohje-ftohje, Punonjes per dyer dritare, Përgatitës të konstruksioneve metalike , Termoizolues, Specialist gipsi, dokumenti qe deshmon kualifikimin ne keto profesione eshte keshuar nga institucione jo te akredituara apo te licencuara nga Ministria perkatese....*

.....Operatori nuk disponon me dokumentacion te rregullt e te vlefshme specialistet; 3 (tre) punonjës të certifikuar për punime speciale të saldimit. 2 (dy) specialistë të Certifikuar për “Sistemet CCTV” ose ekuivalent, per shkakun se deshmitet e tyre te kualifikimit jane leshuar nga institucione jo te licencuara apo akredituara sipas ligjit. Kete informacion OBP e disponon per kete operator.....,Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.7. dhe 2.3.8 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë”. Dëshmi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK	NUMRI
Teknik Ndërtimi	2
Teknik IT/Elektronik	1
Hidraulik	2
Elektricitist	2
Instalues dhe riparues të sistemeve ngrohje-ftohje	3
Hekurkthyes	2
Karpentier	3
Betonues	4
Punonjes i izolimeve (Hidroizolues)	2
Termoizolues	2
Murator	2
Suvatues	4
Pllakashtrues	3
Specialist gipsi	2
Punonjes për dyer dritare	2
Bojaxhi	3
Specialist veshje fasade	3
Përgatitës të konstruksioneve metalike	2
Eskavatorist	2
Shofer	4
Automakinista	3

2.3.7/1 Për punonjësit eskavatorist/ automakinist/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë individuale të punës;
- leje drejtimi, certifikate e aftesimit profesional (CAP) për shoferet dhe dëshmi aftesimi profesional (DAP) për manovratorët-automakinistët/eskavatoristët, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet,

kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.8 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kete pjesë të stafit të tij ose si staf mbështetës (me kontrate pune/kontratë bashkëpunimi) si më poshtë:

- a) 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- b) 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4.
- c) 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) 5 (pesë) punonjës të pajisur me çertifikatë : "Specialist për punimet në lartësi".sipas V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- e) 3 (tre) punonjës të certifikuar për punime speciale të saldimit .
- f) 2 (dy) specialistë të certifikuar për "Sistemet CCTV" ose ekuivalent.

Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme).
- Diplomë/Çertifikatë

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

III.7.2. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në SPE, në përpmbushje të pikës së sipërcituar në DT, operatori ekonomik "Ed konstruksion" SHPK në pikën B

“Deklaratë” në seksionin “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” ka bërë deklaram, konkretisht kjo pjesë është ngarkuar në sistem si më poshtë vijon:

-Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit të OE “Ed Konstruksion” shpk;

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve mesatarisht 79 (shtatëdhjetë e nëntë) punonjës për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. Z. [] me profesion Arkitekt, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit teknik/Arkitekt, 2. Z. [] me profesion Ing.Ndërtimi, me profesion Ing.Ndërtimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit teknik/Ing.Ndërtimi; 3. Z. [] me profesion Ing.Ndërtimi (<i>Profili Strukturist</i>), i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit teknik/Ing.Ndërtimi dhe certifikuar si “<i>Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë</i>”; 4. Z. [] me profesion Ing. Elektrik, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit teknik/Ing.Elektrik, 5. Z. [] me profesion Ing. Mjedisi, i punësuar pranë

	shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit teknik/Ing. Mjedis, 6. Z. ... me profesion Ing.Mekanik, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit teknik/Ing.Mekanik, 7. Znj. ... me profesion Ing.Hidroteknik, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit teknik/Ing.Hidroteknik, “Ekspert për ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave”, 8. Z. ... me profesion Ing. Markshajder, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit teknik/Ing. Markshajder, 9. Z. ... me profesion Ing. Gjeolog, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit teknik/Ing. Gjeolog, 10. Z. ... me profesion Ing.Telekomunikacion, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit teknik/Ing.Telekomunikacion, i certifikuar per “sistemet CCTV”, 11. Z. ... i punësuar pranë shoqërisë sonë, certifikuar per sistemet CCTV, 12. Z. ... disponon certifikimin si ekspert zjarrëfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin, i punësuar pranë shoqërisë sonë si ekspert zjarrëfikës ku dhe disponon dokumentacionin ligjor si ekspert zjarrefikse (I pajisur me certifikatën përkatëse). 13. Z. ... me profesion Ing.Ndërtimi (Profili Strukturist), e punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin Ing.Ndërtimi. 14. Z. ... me profesion Ing.Elektrik, e punësuar pranë
--	---

	shoqërisë sonë, në rolin Ing. Elektrik, 15. Z. [illegjibël], me profesion Teknik Ndertimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Teknik ndertimi, 16. Z. [illegjibël], me profesion Teknik Ndertimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Teknik ndertimi, 17. Z. [illegjibël], me profesion hidraulik, i punësuar pranë shoqërisë sonë rolin e hidraulikut, 18. Z. [illegjibël], me profesion hidraulik, i punësuar pranë shoqërisë sonë rolin e hidraulikut, 19. Z. [illegjibël], me profesion elektrikist, i punësuar pranë shoqërisë sonë rolin e elektricitit, 20. Z. [illegjibël], me profesion elektrikist, i punësuar pranë shoqërisë sonë rolin e elektricitit, 21. Z. [illegjibël], me profesion Instalues dhe riparues te sistemeve ngrohje-ftohje, i punësuar pranë shoqërisë sonë rolin e Instalues dhe riparues te sistemeve ngrohje-ftohje, 22. Z. [illegjibël], me profesion Instalues dhe riparues te sistemeve ngrohje-ftohje, i punësuar pranë shoqërisë sonë rolin e Instalues dhe riparues te sistemeve ngrohje-ftohje, 23. Z. [illegjibël], me profesion hekurkthyes, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e hekurkthyesit, certifikuar edhe si punonjes ne lartesi, 24. Z. [illegjibël], me profesion hekurkthyes, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e hekurkthyesit, 25. Z. [illegjibël], me profesion karpentier, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e karpentierit, certifikuar edhe si punonjes ne lartesi, 26. Z. [illegjibël], me profesion karpentier, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në
--	--

	rolin e karpentierit, 27. Z. [illegible] me profesion betonues, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e betonues, 28. Z. [illegible] me profesion hidroizolues, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e hidroizoluesit, 29. Z. [illegible] me profesion termoizolues, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e termoizolues, 30. Z. [illegible] me profesion termoizolues, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e termoizolues, 31. Z. [illegible] me profesion murator, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e muratorit, 32. Z. [illegible] me profesion murator, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e muratorit, 33. Z. [illegible] me profesion suvatues, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e suvatues, 34. Z. [illegible] me profesion pllakashtrues, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e pllakashtruesit, 35. Z. [illegible] me profesion pllakashtrues, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e pllakashtruesit, 36. Z. [illegible] me profesion specialist gipsi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e specialist gipsi, 37. Z. [illegible] me profesion bojaxhi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e bojaxhiut, 38. Z. [illegible] me profesion veshje fasade, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e veshje fasade, 39. Z. [illegible] me profesion
--	--

	përgatitës të konstruksioneve metalike dhe te ngjashem, i punësuar pranë shoqërisë sonë rolin e përgatitës të konstruksioneve metalike dhe te ngjashem (montator), 40. Z. [Emri i Personit] me profesion përgatitës të konstruksioneve metalike dhe te ngjashem, i punësuar pranë shoqërisë sonë rolin e përgatitës të konstruksioneve metalike dhe te ngjashem (montator), 41. Z. [Emri i Personit] me profesion drejtues i mjeteve të rënda eskavatorist, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Eskavatoristit, 42. Z. [Emri i Personit] me profesion drejtues i mjeteve të rënda eskavatorist, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Eskavatoristit, 43. Z. [Emri i Personit] me profesion drejtues i mjeteve të rënda eskavatorist, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Eskavatoristit, 44. Z. [Emri i Personit] me profesion drejtues i mjeteve të rënda eskavatorist, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Eskavatoristit, 45. Z. [Emri i Personit] me profesion shofer, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e shoferit, 46. Z. [Emri i Personit] me profesion shofer, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e shoferit, 47. Z. [Emri i Personit] me profesion shofer, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e shoferit, 48. Z. [Emri i Personit] me profesion shofer, kontraktuar me kontrate per mjetet e marra me qera deklaruar ne kete procedure prokurimi, 49. Z. [Emri i Personit] me profesion drejtues i mjeteve të rënda Automkinist, i punësuar pranë
--	--

	shoqërisë sonë, në rolin e Automakinistit, 50. Z. [] me profesion drejtues i mjeteve të rënda Automakinist, kontraktuar me kontrate për mjetet e marra me qera deklaruar në këtë procedurë prokurimi, 51. Z. [] me profesion drejtues i mjeteve të rënda Automakinist, kontraktuar me kontrate për mjetet e marra me qera deklaruar në këtë procedurë prokurimi, 52. Z. [] me profesion punonjes specialist për punimet në lartësi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e specialist për punimet në lartësi, 53. Z. [] me profesion punonjes specialist për punimet në lartësi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e specialist për punimet në lartësi, 54. Z. [] me profesion punonjes specialist për punimet në lartësi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e specialist për punimet në lartësi, 55. Z. [] me profesion saldator, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e punonjës të certifikuar për punime speciale të saldimit, Makineri e mjete Po [X] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete
--	---

III.7.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.7.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.7.6. Në nenin 77, pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të

njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.7.7. Neni 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.7.8. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.7.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve² të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

² Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shogëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike³. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.7.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto

dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “**Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e pikave 2.3.7 dhe 2.3.8 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si më sipër cituar, operatori ekonomik “Ed Konstruksion” shpk ka dorëzuar formularin e tij përmbledhës të vetëdeklarimit në lidhje me këto kritere, dokument të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim, mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “Ed Konstruktion” shpk me dorëzimin e Formularit të tij Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës, konkretisht ka deklaruar numrin e punonjësve që disponon, si dhe profilet e parashikuara në pikën 2.3.7 dhe 2.3.8 të dokumenteve të tenderit. Për më tepër, autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë prokurimi dhe përpara publikimit të njoftimit nuk ka zbatuar përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 26 të VKM, ku thuhet, se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, objekt - ankimimi, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesën për **dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.** Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t’i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit.

III.7.11. Nisur nga pretendimet e BOE ankimuese, për plotësimin e këtyre pikave (2.3.7+2.3.8), operatori ekonomik “Ed Konstruktion” SHPK ka dorëzuar, në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), Formularin e tij Përmbledhës të Vetëdeklarimit ku në Pjesën III “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” të tyre, shkronja B – Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” (nëse kërkohen) kanë deklaruar disponimin e punonjësve sipas numrit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit kriteri 2.3.7 dhe 2.3.8, dhe profileve të kërkuara, për të cilat në këtë fazë procedurale është kërkuar se do të plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të ofertuesit. Referuar kriterëve të sipërcituar, dhe nenit 26 të VKM 285, dokumentacioni i nevojshëm për këtë fazë është dorëzimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili është dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues, duke deklaruar disponimin e numrit të punonjësve dhe profileve në përputhje me kriterin e kualifikimit, duke përmbushur në këtë mënyrë si numrin punonjësve të stafit teknik ashtu dhe profilet e tyre.

Për këtë arsye, për sa kohë, nga vetë autoriteti kontraktor është specifikuar në dokumentet standarde të tenderit, se këto kriteret do të quhen të përmbushur me dorëzimin e shtojcës 8, pra Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe akoma më tej në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë. Nga një korrespondencë e mëparshme midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresën nr. 319/1 prot., datë 19.01.2022, protokolluar me tonën nr. 2472/5 prot., 21.01.2022, Agjencia Prokurimit Publik njofton Komisionin e Prokurimit Publik ndër të tjera se: [...] *Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve, duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, plotësimi i kësaj deklarate do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi [...].*

KPP vlerëson, se ligjvënësi ka parashikuar dy momente të përcaktimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”. Momenti i parë lidhet me kriteret e kualifikimit, si përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, gjendjen ekonomike dhe financiare, aftësinë teknike dhe profesionale., në të cilat ligjvënësi i ka lënë në diskrecion të autoritetit kontraktor për përcaktimin e tyre, diskrecion, i cili edhe në kuptim të nenit 11 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, nuk mund të tejkalojë kufijtë e vendosur nga ligji dhe konkretisht, atë të vendosur në nenin 77 të ligjit për prokurimin publik, pra të jenë në proporcion me natyrën, volumin dhe përmasat e kontratës, si edhe të mos jenë diskriminuese. Së dyti, është grupi i kriterëve të kualifikimit të cilat janë të shprehura qartësisht në ligj ose në akt nënligjor dhe që janë detyruese për të gjithë autoritetet kontraktore. Pra, elementët që janë të domosdoshme për të përmbushur fazën e parë të vetëdeklarimit në drejtim të disponueshmërisë së stafit teknik në rastin konkret, është vetëm plotësimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, duke dhënë informacionin e nevojshëm sipas edhe komunikimit të Agjencisë së Prokurimit Publik. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga OE “Ed Konstruksion” shpk në procedurën e prokurimit, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm, për këtë fazë.

Për sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “BE - IS” Shpk & “ERGI” Shpk & “HTM” Shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Ed Konstruksion” Shpk, me arsyen se: “.....Operatori nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të sakte sic kerkohet në **piken 2.3.9/b** të KVK-se pasi Fleta ose fletët e

katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjeve/materialeve, nuk i ka paraqitur në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar. Për sa me siper, operatori ED Konstruksion shpk duhet te skualifikohet.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.8.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.9/b. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.9/b *Të paraqiten katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit të autorizuar nga prodhuesi, për të gjitha paisjet/materialet sipas pikës 2.3.9. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë pajisja/materiali që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje/materiale.*

Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjeve/materialeve, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar.

III.8.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Ed Konstruksion” SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Autorizime_katalog_pj1.pdf, të përkthyer dhe noterizuar;
- Autorizime_katalog_pj2.pdf, të përkthyer dhe noterizuar;
- Autorizime_katalog_pj3.pdf, të përkthyer dhe noterizuar;

III.8.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.8.4. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.8.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për*

kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.8.6. Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma

ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor. 3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara. 4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.8.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.8.8. Në lidhje me kriterin 2.3.9/b të dokumnetave të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar që ofertuesit të paraqesin katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit të autorizuar nga prodhuesi, për të gjitha paisjet/materialet sipas pikës 2.3.9. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë pajisja/materiali që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje/materiale. Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjeve/materialeve, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar. Në përmbushje të kësaj pike, ofertuesi Ed Konstruksion” shpk, ka dorëzuar në SPE dokumentacionin e cituar në pikën III.8.2, i cili është i noterizuar dhe i përkthyer në gjuhën shqipe. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga OE “Ed Konstruksion” shpk në procedurën e prokurimit, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm, për këtë fazë.

Për sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.9. Në lidhje me pretendimet e BOE ankimues për kualifikimin e BOE “KEVIN CONSTRUKSION” sh.p.k & “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik, nuk do ti marri në shqyrtim për aq kohë sa, referuar arsyetimit të bërë në këtë vendim statusi juridik i OE “Ed Konstruksion” shpk, i renditur para BOE ankimues, vazhdon të mbetet i kualifikuar, e për rrjedhim nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qenë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar. Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimet e ankimuesit nuk do të merren në shqyrtim.

III.10. Në lidhje me pretendimet e BOE ankimues për anulimin e procedurës për shkak të kriterit në pikën 2.3.1, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor, deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]*”. Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

III.11. Në lidhje me pretendimet e BOE ankimues për vlerësimin me pikë të nënkriterit të “Kualifikimit/Përvoja e stafit teknik”, Komisioni gjykon se, për sa kohë që autoriteti kontraktor do të skualifikojë subjektin “Inerti” shpk, i cili është i renditur i pari në klasifikim, duke ripërlllogaritur edhe një herë pikët për ofertuesit e kualifikuar, duke ndryshuar në këtë mënyrë renditjen dhe pikët e tyre, Komisioni nuk mund të shprehet në lidhje me këtë pretendim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave

nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE ankimues “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k & “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF- 60262-09-03-2025, me objekt “Ndërtimi i një kompleksi poligoni qitjeje dhe palester për forcat operacionale dhe ato speciale në Sistemin e Burgjeve”, me fond limit 296,309,312.26 (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e treqind e nëntë mijë e treqind e dymbëdhjetë pikë njëzet e gjashtë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
 2. Të mos pranojë ankesën e BOE ankimues “BE - IS” Shpk & “ERGI” Shpk & “HTM” Shpk, për procedurën e prokurimit sipërcituar.
 3. Autoriteti kontraktor të skualifikojë OE “Inerti” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE ankimues “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k & “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k.
 6. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga BOE ankimues “BE - IS” Shpk & “ERGI” Shpk & “HTM” Shpk.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

